



# Essential Plan

## Në një vështrim të shpejtë



### KUSH KUALIFIKOHET?

#### INDIVIDË QË:

- Janë banorë të New York State
- Mund të përmbushin kërkesat për të ardhurat e Essential Plan
- Janë rezidentë të ligjshëm në SHBA
- Janë 19-64 vjeç
- Nuk kualifikohen për "Medicaid" ose "Child Health Plus"
- Nuk kualifikohen për mbulim punëdhënësi dhe mbulime të tjera

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

### ÇFARË MBULOHET?

- Kujdes parandalues falas
- Kujdes për pacientë të brendshëm
- Shërbime ambulatorë
- Kujdes neonatal dhe për nënën
- Shërbime emergjence
- Laborator dhe imazheri
- Barna me recetë
- Shërbime rehabilitimi dhe trajtimi
- Shërbime për persona me çrregullime të shëndetit mendor ose të përdorimit të substancave
- Shërbime trajtimi dhe menaxhimi të sëmundjeve kronike
- Kujdes okulistik dhe dentar

### NA KONTAKTONI:

[nystateofhealth.ny.gov](https://nystateofhealth.ny.gov) | 1-855-355-5777 ose TTY 1-800-662-1220

# SA KUSHTON ESSENTIAL PLAN?

**PRIMET:** Primi mujor është \$0 (falas) për personat që kualifikohen.

**NDARJA E KOSTOVE:** NUK ka **TARIFA TË ZBRITSHME**. Më poshtë paraqiten disa shembuj të niveleve të ndarjes së kostove të Essential Plan.

| NDARJA E KOSTOVE PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR               | Të ardhura vjetore individuale:<br>nën \$15,060 - \$22,590  | Të ardhura vjetore individuale:<br>\$22,591 - \$37,650** |
|---|---|--|
| <b>Primi mujor</b>  | <b>\$0</b>  | <b>\$0</b>   |
| Tarifat e zbritshme vjetore   | Nuk ka  | Nuk ka   |
| Kujdesi parandalues   | Falas   | Falas  |
| Vizitë mjeku e kujdesit parësor                                     | \$0   | \$15   |
| Vizitë te specialisti   | \$0   | \$25   |
| Shtrim në spital për pacientë të brendshëm                          | \$0   | \$150  |
| Vizitë shëndetësore e sjelljes për pacientë të jashtëm              | \$0   | \$15   |
| Vizitë shëndetësore e sjelljes për pacientë të brendshëm për shtrim | \$0   | \$150  |
| Sallë emergjence  | \$0   | \$75   |
| Kujdes urgjent  | \$0   | \$25   |
| Terapi fizike, terapi ligjërimi, terapi okupacionale                | \$0   | \$15   |
| NDARJA E KOSTOVE PËR BARNAT ME RECETË                               | Të ardhura vjetore individuale:<br>nën \$15,060 - \$22,590* | Të ardhura vjetore individuale:<br>\$22,591 - \$37,650   |
| Të përgjithshme   | \$1   | \$6  |
| Markë e preferuar   | \$3   | \$15   |
| Markë jo e preferuar  | \$3   | \$30   |
| * \$0 për individë me të ardhura nën \$13,590.                      |   |  |
| NDARJA E KOSTOVE PËR PËRFITIMET DENTARE DHE OKULISTIKE              | Të ardhura vjetore individuale:<br>nën \$15,060 - \$22,590  | Të ardhura vjetore individuale:<br>\$22,591 - \$37,650   |
| Kujdes dentar dhe okulistik   | \$0   | \$0  |